FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

NIKOTINAMID

Tableta - 200 mg
(Nikotinamid)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Nikotinamid dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Nikotinamid
3. Si ta merrni Nikotinamid
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Nikotinamid
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË NIKOTINAMID DHE PËRSE PËRDORET

Nikotinamidi dhe acidi nikotinik (vitamina PP) bëjnë pjesë në vitaminat e tretshme në ujë, të grupit të vitaminës B. Në organizëm shndërrohen në nikotinamidadenindinukleotid (NAD) dhe në fosfat të nikotinamidadenindinukleotidit (NADP). Këto dy produkte të fundit janë koenzima të rëndësishme që marrin pjesë në proçeset e frymëmarrjes.
Pamjaftueshmëria e acidit nikotinik shfaqet kur marrja me ushqimet është e papërshtatshme.
Pamjaftueshmëria shpie në zhvillimin e një sindromi që njihet me emrin pelagra, e cila karakterizohet me lezione të lëkurës, sidomos të sipërfaqeve që ekspozohen në dritën e diellit, me hiperpigmentim dhe hiperkeratinizim. Mund të shfaqen edhe simptoma të tjera, si: diarre, dhimbje barku, glosit, stomatit, anoreksi, dhimbje koke, letargji dhe çrregullime mendore e neurologjike.

Indikohet në:

- rastet e rritjes së nevojave për nikotinamid, si p.sh. në periudhën e shtatzënisë dhe të ushqyerjes së fëmijëve me gji;
- personat e dobësuar dhe në diabetikët;
- një varg sëmundjesh organike dhe funksionore të enëve të trurit (arterosklerozë obliterante, emboli trunore, migrenë spastike);
- sëmundje organike të enëve periferike (morbus Buergeri);
- dëmtime funksionore të enëve periferike, si sëmundja Reino, akrocianoza;
- sëmundje infektive, çrregullime të metabolizmit, alergji, anoreksi, të vjella;
- oftalmologji; përdoret në djegie të konjunktivës dhe kornesë nga nxehtësia dhe lëndët kimike, në sëmundje të fundus okuli dhe të nervit optik me bazë vaskulare;
- otorino-laringologji; indikohet në dëmtimet spastike të dëgjimit dhe dëmtimet vestibulare;
- stomatite, glosite, xhinxhivite, afte;
- dermatologji; përdoret në ekzemë, morth, dermatite toksike, alopeci areata.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Nikotinamid për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Nikotinamid.

2. PËRPARA SE TË MERRNI NIKOTINAMID

Mos merrni Nikotinamid në qoftë se:

- jeni me gjendje hemorragjike (hemorragji në traktin gastrointestinal, hemorragji cerebrale, hemoptizi, hematuri);
- vuani nga glomerulonefriti akut;
- vuani nga vese të dekompensuara të zemrës;
- keni kaluar infarkt miokardi.

Tregoni kujdes të veçantë me Nikotinamid

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- jeni të sëmurë me të dhëna të mëparshme për ulçer peptike;
- jeni të sëmurë me gutë;
- keni dëmtim të funksionit të mëlçisë;
- pacienti është i moshuar.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Nikotinamid.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Nikotinamid në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sidomos këta të mëposhtmit:

- beta-bllokues, sepse efekti antihipertensiv i tyre mund të fuqizohet nga Nikotinamid;
- lovastatin, sepse përdorimi në të njëjtën kohë me të mund ta shtojë rrezikun e miopatisë.

Marrja e Nikotinamid me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna për bashkëveprimin e këtij bari me ushqimin dhe pijen.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë.
Nikotinamid është i indikuar të përdoret në shtatzëni.

Ushqimi me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Nikotinamid është i indikuar të përdoret gjatë ushqyerjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nikotinamid nuk e ul aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Nikotinamid

Nikotinamid përmban laktozë. Flisni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar në qoftë se jeni në dijeni se vuani nga intoleranca ndaj disa sheqernave.

3. SI TA MERRNI NIKOTINAMID

Doza e zakonshme është 200 mg, 2-3 herë në ditë. Gjithmonë merrini tabletat Nikotinamid vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Nikotinamid janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Nikotinamid për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni i sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

Në qoftë se keni marrë më shumë Nikotinamid

Në qoftë se keni marrë më shumë Nikotinamid se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Nikotinamid

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson. Përdorimi për kohë të gjatë dhe me doza të larta mund të favorizojë këto efekte:

- degjenerime konjunktive dhe yndyrore;
- hipertrofi të mëlçisë.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI NIKOTINAMID

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni barin pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Nikotinamid?

Lënda vepruese është nikotinamidi.
Çdo tabletë përmban 200 mg nikotinamid.
Përbërësit e tjerë janë: amidon, laktozë, povidon, celulozë mikrokristalore, stearat magnezi, talk dhe glikolat natriumi i amidonit.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Maj 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.